



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA AKADEMIA E DREJTËSISË AKADEMIJA PRAVDE - ACADEMY OF JUSTICE			
Njësia. Org. Org. Unit	01	Nr. Prot. Pr. Prot.	765
Nr. Faqeve Br. Stranica No. Pages	01	Data Datum Date	31.07.2026
Prishtinë / a			



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues / Upravni Odbor/ Steering Committee

Nr. 01/ **765**/2026
Datë: 30/07/2026

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në bazë të nenit 10 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe nenin 6, paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik më datë 30 Korrik 2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja Nr. 04/2026 për Transferimin e Nëpunësve në Akademinë e Drejtësisë.
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtoria Ekzekutiv të AD-së;
- Drejtoreshës së DSHLP-së;
- Burimeve Njerëzore të AD-së
- Arkivit të Akademisë së Drejtësisë

Fejzullah Rexhepi

Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë,

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe nenit 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 korrik 2026, miraton:

RREGULLORE NR.04/2026

PËR TRANSFERIMIN E NËPUNËSVE TË AKADEMISË SË DREJTËSISË

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për transferimin e përkohshëm, të përhershëm dhe transferimin në rast të ristrukturimit për nëpunësit në Akademinë e Drejtësisë.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë nëpunësit civilë me status të veçantë në Akademinë e Drejtësisë.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1 Zyrtari përgjegjës – nënkupton Zyrtarin e lartë për Burime Njerëzore.

2. Shprehjet, termat dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtë si në Ligjin për zyrtarët publik.

3. Përdorimi i emrit në njërën gjini, nënkupton edhe gjininë tjetër.

KAPITULLI I

TRANSFERIMI I PËRKOHSHËM

Neni 4

Transferimi i Përkohshëm

1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori në këto raste:

1.1. kur është në interes të institucionit, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve;

1.2. për përmirësimin e rezultateve të punës të vetë nëpunësit që është vlerësuar sipas nivelit “ka nevojë për përmirësim” apo “e papranueshme”, prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve;

1.3. për arsye të përkohshme shëndetësore, për aq sa është e nevojshme sipas vendimit të komisionit përkatës.

2. Transferimi i përkohshëm si në paragrafin 1 të këtij neni mund të bëhet:

2.1. brenda institucionit ku është emëruar;

2.2. në një institucion tjetër në kuadër të shërbimit civil.

3. Transferimi i përkohshëm në një institucion tjetër të shërbimit civil bëhet përmes marrëveshjes paraprake në mes të institucionit ku nëpunësi është aktualisht i punësuar dhe institucionit ku nëpunësi transferohet.

4. Transferimi i përkohshëm është i detyrueshëm, përveç rasteve si në vijim:

4.1. kur gjendja e tij shëndetësore, e dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;

4.2. nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil.

5. Nëpunësi i transferuar pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm kthehet në pozitën e mëparshme.

6. Transferimi i përkohshëm në rastet e parashikuara paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij neni, nuk mund të bëhet për nëpunësit të cilët janë në periudhë provuese.

Neni 5

Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit

1. Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit, me kërkesë të institucionit.

2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit mund të propozohet nga Udhëheqësi i Drejtpërdrejtë i nëpunësit apo drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit.

3. Vendimi për transferim është vendim i arsyetuar i drejtuesit më të lartë administrativ të institucionit.

4. Arsyetimi i vendimit të transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga zyrtari përgjegjës në Akademinë e Drejtësisë.

5. Zyrtari përgjegjës e njofton me shkrim nëpunësin që do të transferohet lidhur me vendimin e transferimit.

6. Transferimi sipas këtij neni, mund të bëhet në periudhë prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve.

Neni 6

Transferimi i përkohshëm për përmirësimin e rezultateve të punës

1. Nëpunësi civil mund të transferohet për përmirësimin e rezultateve të punës së tij në qoftë se është vlerësuar sipas nivelit “ka nevojë për përmirësim” apo “e papranueshme”.

2. Rekomandimi për transferim sipas këtij neni bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt, në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës.

3. Vendimi për transferim sipas këtij neni, merret nga drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit.

4. Transferimi sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, mund të bëhet në periudhë prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj gjatë dy (2) viteve.

Neni 7

Transferimi i përkohshëm për arsye shëndetësore

1. Transferimi i përkohshëm për arsye shëndetësore bëhet me kërkesë të nëpunësit civil, pas vendimit të komisionit kompetent mjekësor.

2. Në vendimin e komisionit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përcaktohet kohëzgjatja e nevojshme e transferimit të përkohshëm për arsye shëndetësore.

3. Pas pranimit të vendimit nga Komisioni sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, drejtuesi më i lartë administrativ i institucionit nxjerr vendimin për transferim.

Neni 8

Transferimi i përkohshëm në një Institucion tjetër apo në një organizatë ndërkombëtare

1. Nëpunësi mund të transferohet përkohësisht me vendim të drejtuesit më të lartë administrativ, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar.

2. Kohëzgjatja e transferimit të përkohshëm sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet në kohëzgjatje siç është përcaktuar në marrëveshjen përkatëse apo legjislacionin e veçantë në fuqi.

Neni 9

Kompensimet e shpenzimeve të udhëtimit të transferimit të përkohshëm

Nëpunësi civil që transferohet në një vend tjetër pune me kërkesën e institucionit, në një komunë tjetër nga komuna ku është vendi i rregullt i punës, ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit nga institucioni ku transferohet nëpunësi civil.

KAPITULLI II

TRANSFERIMI I PËRHERSHËM

Neni 10

Transferimi i përhershëm

1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit në një pozitë tjetër të shërbimit civil, në rast të:

1.1.paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme;

1.2.shmangies së një konflikti të vazhdueshëm interesi, të përcaktuar me ligj;

1.3.përfundimit të pezullimit, me kërkesë të nëpunësit kur ai nuk mund të kthehet në pozitën e mëparshme të punës;

1.4.shqiptimit të transferimit si masë e pamjaftueshmërisë profesionale;

1.5.shqiptimit të transferimit si masë disiplinore.

2. Transferimi i përhershëm sipas nën paragrafëve 1.1. dhe 1.3. të paragrafit 1 të këtij neni është vendim i Drejtorit Ekzekutiv dhe bëhet pas kërkesës së nëpunësit civil.

3. Transferimi i përhershëm sipas nën paragrafit 1.2. të këtij neni është vendim i Drejtorit Ekzekutiv.

4. Transferimi i përhershëm sipas nënparagrafit 1.4. të paragrafit 1 të këtij neni, është vendim i Drejtorit Ekzekutiv pas pëlqimit të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë.

5. Transferimi i përhershëm sipas nënparagrafit 1.5. të paragrafit 1 të këtij neni, shqiptohet nga Komisioni Disiplinor i Akademisë së Drejtësisë.

6. Transferimi i përhershëm sipas këtij neni mund të bëhet brenda Akademisë së Drejtësisë ku nëpunësi civil është i punësuar.

7. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni transferimi i përhershëm për interes të institucionit bëhet në kategori të njëjtë në shërbimin civil.

Neni 11
Transferimi i përhershëm për interes të Institucionit

1. Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në kategori të njëjtë, ose në kategori të ndryshme, pa u dëmtuar në pagë për shkak të transferimit.
2. Për rastet kur nëpunësi civil është i nivelit të ulët, mesëm apo të lartë drejtues, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar.
3. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër që punëson nëpunës civilë.
4. Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, Drejtorin Ekzekutiv dhe me pëlqimin e nëpunësit civil.
5. Transferimi i nëpunësit civil në një institucion tjetër që punëson nëpunës civilë, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunësit dhe me marrëveshje në mes të institucioneve.
6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste:
 - 6.1.kur gjendja e tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e pamundëson transferimin;
 - 6.2.nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil; dhe
 - 6.3.për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin.
7. Arsyet objektive për refuzim të transferimit sipas nënparagrafit 6.3 të paragrafit 6 të këtij neni, vlerësohen rast pas rasti nga Drejtori Ekzekutiv dhe dëshmohen me dëshmitë përkatëse nga nëpunësi.
8. Arsyetimi i vendimit të transferimit të përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga Zyrtari përgjegjës në Akademi.
9. Në rastet e transferimit jashtë institucionit, vlerësimi sipas paragrafit 8 të këtij neni bëhet në bashkëpunim mes zyrtarit përgjegjës të dy institucioneve.

KAPITULLI III

TRANSFERIMI NË RAST TË SHUARJES APO RIORGANIZIMIT

Neni 12

Transferimi për shkak të shuarjes apo riorganizimit të Institucionit

1. Nëse për shkak të shuarjes apo riorganizimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të shërbimit civil.
2. Transferimi sipas paragrafit 1. të këtij neni, mund të bëhet:
 - 2.1 në të njëjtin institucion;
 - 2.2 në institucionin që është bashkuar institucioni i shuar, në institucionin që është ndarë, apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi.
3. Transferimi bëhet sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni. Nëse nuk ka pozita të lira të së njëjtës kategori apo nëpunësi nuk plotëson kërkesat e pozitës së punës në të njëjtin institucion sipas nënparagrafit 2 të këtij neni, transferimi i tij mund të bëhet në institucionin tjetër sipas radhës së përcaktuar në paragrafin 2.2.
4. Nëpunësit e institucionit të riorganizuar njoftohen individualisht nga zyrtari përgjegjës në Akademi për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit. Njoftimi bëhet menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit të institucionit.

Neni 13

Komisioni për Riorganizim

1. Në rastet e shuarjes apo riorganizimit të institucionit, zyrtari përgjegjës në Akademi brenda 30 ditëve nga miratimi i aktit të riorganizimit krijon një komision riorganizimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, për të cilën ky i fundit i plotëson kërkesat e vendit të punës.
2. Komisioni udhëhiqet nga zyrtari përgjegjës në Akademi, dhe nga dy anëtarë tjerë, me përvojë pune të konsiderueshme nga Akademia e Drejtësisë.
3. Komisioni, brenda dyzetepesë (45) ditëve nga data e themelimit, i propozon me shkrim NJMBNJ-së, transferimin e nëpunësit siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje.
4. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve për shkak të riorganizimit të institucionit mbështetet në përshkrimet e vendeve të lira apo të atyre të krijuara të punës dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve.
5. Vendimi është individual për çdo nëpunës.
6. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve për shkak të riorganizimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere:
 - 6.1.përvojën e nëpunësit në shërbimin civil;

- 6.2.mesataren e vlerësimeve të rezultateve në punë të nëpunësit për tre (3) vitet e fundit;
 - 6.3.kualifikimet profesionale të nëpunësit; dhe
 - 6.4. trajnimet e nëpunësit.
7. Komisioni i riorganizimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter.

Neni 14

Procedura e transferimit në rast riorganizimit

1. Zyrtari përgjegjës në Akademi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga komisioni i riorganizimit, vendos për transferimin e nëpunësit dhe njofton nëpunësin për vendimin.
2. Nëpunësi mund të refuzojë transferimin vetëm për këto arsye:
 - 2.1.kur gjendja e tij shëndetësore, e dëshmuar me vërtetim mjekësor, e bën transferimin të pamundur;
 - 2.2.nëse vendi ku transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil.
3. Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin sipas paragrafit 2 të këtij neni brenda afatit prej pesë (5) ditëve nga pranimi i vendimit për transferim.
4. Zyrtari përgjegjës në Akademi verifikon shkaqet e refuzimit dhe mund të shfuqizojë vendimin nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni dhe të vendosë për transferimin në një pozitë tjetër.
5. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera nga ato të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, përbën shkak për lirim nga shërbimi civil.
6. Nëpunësit civil që pas shuarjes apo riorganizimit të institucionit nuk kanë mundur të transferohen në një pozitë tjetër të shërbimit civil për shkak të mungesës së pozitave të lira, apo mosplotësimit të kërkesave të pozitave të punës së kategorisë përkatëse, do të vendosen në listën e pritjes.

Neni 15

Paga me rastin e transferimit për shkak të riorganizimit të institucionit

1. Nëpunësi i transferuar në pozitën e të njëjtës kategori që ka qenë, për shkak të ristrukturimit të institucionit, e merr pagën e pozitës në klasën që është transferuar.
2. Deri në momentin e përfundimit të procedurës së transferimit sipas nenit 14 të kësaj Rregulloreje, nëpunësi merr pagën e njëjtë që e ka pasur para përfundimit të transferimit.

Neni 16
E drejta e ankesës

Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i cilitdo vendim të nxjerrë sipas kësaj Rregulloreje, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.


Fejzullah Rexhepi
Kryesues i Këshillit Drejtues
Akademia e Drejtësisë